REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E ARSIMIT, SHKENCËS DHE TEKNOLOGJISË
UNIVERSITETI UNIVERZITET "HAXHI ZEKA" PEJË
REKTORATI
Nr. / Br. / No. 382 Nr. i faq/ Br. str / No. pg 4
Data / Datum / Date: 22.02.2023 Pejë / Peć

UNIVERSITETI - UNIVERSITY - UNIVERZITET
"HAXHI ZEKA"

Ref. nr. 382 Pejë

# RREGULLORE PËR DHËNIEN E TITULLIT "PROFESOR EMERITUS" NË UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" NË PEJË

**Pejë,**
**20.02.2023**

Në bazë te nenit 42, pikës 1.19 të nenit 48 dhe nenit 177, të Statuti nr. 04-V-622 të Universitetit "Haxhi Zeka" në Pejë, Senati i UHZ – së, në mbledhjen e mbajtur më dt. .2023, miratoj këtë:

## RREGULLORE PËR DHËNIEN E TITULLIT "PROFESOR EMERITUS" NË UNIVERSITETIN "HAXHI ZEKA" NË PEJË

Sipas nenit 177, pikat 1,2,3, dhe 4 të Statutit të Universitetit "Haxhi Zeka" (më tej UHZ) mund të akordojë titullin "Profesor Emeritus" të UHZ-së.

### Neni 1
### Qëllimi

Qëllimi i rregullores për dhënien e titullit "Profesor Emeritus" në universitetin "Haxhi Zeka" është të përcaktojë kushtet, privilegjet, përgjegjësitë dhe revokimin lidhur me dhënien e titullit "Profesor Emeritus" të universitetit "Haxhi Zeka".

### Neni 2
### Fushëveprimi

Kjo rregullore zbatohet në gjithë universitetin "Haxhi Zeka" dhe për të gjithë personelin akademik të rregullt të këtij institucioni.

### Neni 3
### Procedurat për zgjedhjen e "Profesor Emeritus"

1. Propozimi për dhënien e statusit "Profesor Emeritus" bëhet me rekomandimin e shumicës e anëtarëve të këshillit të dy Njësive Akademike propozuese të UHZ-së.
2. Dekani i njësisë akademike, ku i propozuari për "Profesor Emeritus" është i punësuar, duhet t'i drejtojë rekomandimin, materialet mbështetëse, duke përfshirë dhe një letër rekomanduese, rektorit të UHZ-së.
3. Rektori pas pranimit të dosjes së kandidatit për "Profesor Emeritus" i paraqet senatit në mbledhjen e parë të tij propozimin e njësive akademike kandidatin për dhënien e Titulli "Profesor Emeritus".
4. Për dhënien e titullit "Profesor Emeritus" Senati duhet te votoj me 2/3 e votave.

**Neni 4**
**Kushtet për nominim të "Profesor Emeritus"**

1. Gjashtë muaj para pensionimit, çdo pjesëtar i fakultetit që plotëson kushtet e mëposhtme mund të konsiderohet për rekomandim për statusin "Profesor Emeritus":
   1.1. Kandidati pensionohet në UHZ;
   1.2. Mban titullin Profesor i rregullt i UHZ-së;
   1.3. Ka punuar së paku dhjetë (10) vite në UHZ;
   1.4. Gjatë viteve të punës në UHZ ka pasur gjithmonë performancë të Mire
   1.5. Dallohet nga arritjet e vecanta akademike, shkencore, profesionale dhe pedagogjike gjatë periudhës së aktivitetit të tij.
   1.6. Kualifikimet e tij konsiderohen të pazëvendësueshme për një periudhë afatmesme nga ana e njësisë akademike;
   1.7. Ka fituar reputacion ndërkombëtar;
   1.8. Ka arritur rezultate të rëndësishme në ofrimin e risive mësimore – Shkencore;
   1.9. Ka fituar merita të veçanta për zhvillimin dhe mbarëvajtjen e Universitetit dhe të fakultetit që e propozoi për dhënien e titullit;
   1.10. Ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në reputacionin dhe afirmimin e Universitetit dhe të fakulteteve të tij brenda dhe jashtë vendit
   1.11. Mos e ketë shkelur asnjëherë Kodin e Etikës dhe të kundër tij mos të jetë shqiptuar asnnjë masë disiplinore.

**Neni 5**
**Të drejtat e "Profesor Emeritus"**

1. Të marrë pjesë në kryerjen e të gjitha formave të mësimdhënies në studimet akademike të shkallës së dytë dhe të tretë, si dhe në studimet e specializuara profesionale, në fushën më të ngushtë për të cilën është zgjedhur deri në moshën (70) vjeçare por thirrja profesor emeritus është e përhershme;
2. Vendosjen e emrit në listën e "Profesorëve Emeritus" të njësisë akademike përkatëse;
3. Akses në emailin zyrtar të UHZ-së;
4. Qasje në bibliotekën e UHZ-së;
5. Të drejtë në pjesëmarrje në ngjarjet që organizohen nga UHZ;
6. të jetë anëtar i komisioneve në procesin e përgatitjes dhe mbrojtjes së punimeve përfundimtare, d.m.th disertacion mbi ato studime;
7. Të marrë pjesë në punën shkencore dhe kërkimore në Universitet;
8. Ka një rol këshillues në universitet dhe fakultet, në përputhje me nevojat e universitetit dhe fakultetit.

**Neni 6**
**Përgjegjësitë e "Profesor Emeritus"**

Çështjet rreth përgjegjësive të "Profesor Emeritus" caktohen me kontratë individuale të lidhur nga Rektori me propozimin e dekanit të njësisë akademike.

**Neni 7**
**Dhënia e titullit "Profesor Emeritus"**

Universiteti mund t'i japë çdo vit titullin "Profesor Emeritus" maksimumi një (1) profesori në pension dhe duke marrë në konsideratë faktin se numri i "Profesorëve Emeritus" nuk mund të kalojë 1% të numrit të përgjithshëm të personelit akademik të universitetit.

**Neni 8**
**Revokimi i thirrjes "Profesor Emeritus"**

1. Revokimi i thirrjes "Profesor Emeritus" bëhet atëherë kur:

1.2. Përcaktohet se sjellja e individit të cilit i është dhënë titulli "Profesor Emeritus" bie ndesh me qëllimin dhe frymën e UHZ-së dhe/ose shkakton dëmtim të reputacionit të Universitetit.
1.3. Inicimin për revokim të titullit "Profesor Emeritus" e bën dekani i Njësisë Akademike ku profesori emeritus është I angazhuar. Vendimi për revokim bëhet nga Senati me 2/3 e votave.

**Neni 9**
**Kohëzgjatja e titullit "Profesor Emeritus"**

Titulli "Professor Emeritus" është e përhershme.

**Neni 10**
**Pagesa**

Paga e profesorit emeritus përcaktohet në rregulloren për të ardhurat personale në UHZ.

**Neni 11**
**Hyrja në fuqi**

Rregullorja për dhënien e titullit "Profesor Emeritus" në universitetin "Haxhi Zeka" hyn në fuqi ditën e aprovimit në Senat.

**Kryesuesi i Senatit/Rektori:**

Prof. Dr. Armand Krasniqi

# REGULATION FOR AWARDING THE TITLE "PROFESSOR EMERITUS" AT "HAXHI ZEKA" UNIVERSITY IN PEJA

**Peja,**
**20.02.2023**

Based on article 42, point 1.19 of article 48 and article 177, of Statute no. 04-V-622 of the "Haxhi Zeka" University in Peja, the Senate of the UHZ, in the meeting held on .2023, approve this:

**REGULATION FOR AWARDING THE TITLE "PROFESSOR EMERITUS" AT "HAXHI ZEKA" UNIVERSITY IN PEJA**

According to article 177, points 1, 2, 3, and 4 of the Statute of "Haxhi Zeka" University (hereinafter UHZ) can grant the title "Professor Emeritus" of UHZ.

## Article 1
## Purpose

The purpose of the regulation for awarding the title "Professor Emeritus" at "Haxhi Zeka" University is to determine the conditions, privileges, responsibilities and revocation related to the awarding of the title "Professor Emeritus" at "Haxhi Zeka" University.

## Article 2
## Field of action

This regulation applies to the entire "Haxhi Zeka" University and to all regular academic staff of this institution.

## Article 3
## Procedures for the selection of "Professor Emeritus"

1. The proposal for awarding the status "Professor Emeritus" is made with the recommendation of the majority of the council members of the proposing of two Academic Units of UHZ.
2. The dean of the academic unit, where the proposed of "Professor Emeritus" is employed, must direct the recommendation, supporting materials, including a letter of recommendation, to the rector of UHZ.
3. The Rector, after receiving the candidate's file for "Professor Emeritus", presents to the Senate at the first meeting the proposal of the academic units for the award of the "Professor Emeritus" title.
4. For awarding the title "Professor Emeritus", the Senate must vote with 2/3 of the votes.

## Article 4
## Conditions for the nomination of "Professor Emeritus"

1. Six months prior to retirement, any faculty member who meets the following conditions may be considered for recommendation for "Professor Emeritus" status:

1.1. The candidate retires in UHZ itself;
1.2. Holds the title of Full Professor of UHZ;
1.3. Has worked at least ten (10) years in UHZ;
1.4. During the years of working at UHZ, there has always been good performance;
Distinguished by special academic, scientific achievements, professional and pedagogical during the period of his/her activity;
His qualifications are considered irreplaceable for one mid-term period by the academic unit;
1.5. It has gained international reputation;
It has achieved important results in the provision of teaching-scientific innovations;
It has earned special merits for its development and progress the university and the faculty that proposed it for awarding the title;
1.6. It has made an important contribution to the reputation and the affirmation of the University and its faculties at internal and abroad;
1.7. He/She has never violated the Code of Ethics and also no disciplinary measures have been imposed against him.

**Article 5**
**Rights of "Professor Emeritus"**

1. To participate in the performance of all forms of teaching in academic studies of the second and third cycle of studies, as well as in specialized professional studies, in the narrowest field for which he was chosen until the age of (70) but the title professor emeritus is permanent;
2. Setting of the name in the list of "Professors Emeritus" of the relevant academic unit;
3. Access to the official email of UHZ;
4. Access to the UHZ library;
5. Right to participate in events organized by UHZ;
6. To be a member of commissions in the process of preparation and defense of final works, i.e. dissertation on those studies;
7. To participate in scientific and research work at the University;
8. It has an advisory role in the university and faculty, in accordance with the needs of the university and faculty.

**Article 6**
**Responsibilities of "Professor Emeritus"**

Affairs regarding the responsibilities of "Professor Emeritus" are determined by an individual contract related by the Rector with the proposal of the dean of the academic unit.

**Article 7**
**Awarding the title "Professor Emeritus"**

The University may annually award the title "Professor Emeritus" to a maximum of one (1) retired professor and taking into consideration the fact that the number of "Emeritus Professors" may not exceed 1% of the total number of university academic staff.

**Article 8**
**Revocation of the title "Professor Emeritus"**

The revocation of the title "Professor Emeritus" is made when:

1. It is determined that the behavior of the individual who has been given the title "Professor Emeritus" contradicts the purpose and spirit of UHZ and/or causes damage to the reputation of the University.
2. The initiation for revoking the title "Professor Emeritus" is done by the dean of the Academic Unit where the professor emeritus is engaged. The decision on revocation is made by the Senate with 2/3 of the votes.

**Article 9**
**Duration of the title "Professor Emeritus"**

The title "Professor Emeritus" is permanently.

**Article 10**
**Payment**

The wage of the emeritus professor is determined in the regulation on personal income at UHZ.

**Article 11**
**Entry in force**

The regulation for awarding the title "Professor Emeritus" at "Haxhi Zeka" University enters into force on the day of approval in the Senate.

**Chairman of the Senate:**

Prof. Dr. Armend Krasniqi
**Rector of UHZ**